

Nr. 89/11 Prot
Nr. 0002-22 Dosje

Tiranë më 28/02/2022

**URDHËR
"PËR VENDOSJEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE"**

Drejtuar: Qendra Kombëtare e Biznesit

Adresa: Tiranë

Per dijeni: Debitorit : Shoqëria "Shkodra Beton-Inert" shpk Nipt L72025009M

Adresa: Autostrada Tr-Du, km 0, Mbikalimi i Kamzes

Kreditor : Shoqëria "Auto-Manoku" sh.a Nipt K92128001N

Adresa: Rr. Kavajes, Tirane

Pranë Zyrës së Përmbarrimit Privat "BESA" sh.p.k, me kërkesë të palës kreditore është regjistruar çështja përmbarrimore me numër 0002-22 regj dhe me palë:

Kreditor : Shoqëria "Auto-Manoku" sh.a Nipt K92128001N

Debitorit : Shoqëria "Shkodra Beton-Inert" shpk Nipt L72025009M

Objekti : Likuidim Fature

KONSTATOVA:

Për titullin ekzekutiv "Fautrë Tatimore Nr.76, datë 15.05.2019, Faturë Tatimore Nr.78, datë 15.05.2019, Faturë Tatimore Nr.103, datë 06.06.2019, Faturë Tatimore Nr.292, datë 20.11.2019", është lëshuar Urdhri i Ekzekutimit "Vendimi Nr.12965, datë 24/12/2021 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë", me palë kreditore Shoqëria "Auto-Manoku" sh.a dhe palë debitore Shoqëria "Shkodra Beton-Inert" shpk.

Me vendim të përmbarrimit gjyqësor privat, mbështetur dhe në nenin 519 të K.Pr.Civile është kaluar në ekzekutim të detyrueshëm të titullit ekzekutiv, rrjedhimisht për ekzekutimin e tij, duhet te kryhet verifikimi dhe vendosja masës së sekuestros në QKB, mbi aktivin që zotëron pala debitore.

Për këtë arsye në bazë të neneve 527 e në vijim të K.Pr.Civile dhe Ligjit Nr.26/2019, datë 08.05.2019 "Për Shërbimin Përmbarrimor Gjyqësor Privat",

URDHËROJ:

1. Vendosjen e masës së sekuestros konservative në aksionet, kuotat e debitorit:

-Shoqëria "Shkodra Beton-Inert" shpk Nipt L72025009M, si dhe mbi të drejtat që rrjedhin nga zotërimin e këtyre aksioneve/kuotave duke ndaluar tjetërsimin dhe/ose disponimin e tyre si dhe mos kryerjen e asnjë veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrimit tregtar. Dokumentacioni do të qëndrojë i bllokuar deri në një urdhër të dytë.

2. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

3. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhri do të merren masat e parashikuara në nenet 606 e vijues të K. Pr. Civile, si dhe në rast se ka vend do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.

4. Ky urdhër ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.Civile, kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor të vendit të ekzekutimit brenda 5 ditëve nga marrja dijeni.

Zyra e Përmbarrimit Privat "BESA" sh.p.k
PËRMBARUESI GJYQËSOR
Klodiana TABAJ

